



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



REZULTATET E MONITORIMIT

**TË RAPORTIMIT TË MEDIAVE LIDHUR ME TEMAT ME
INTERES SHOQËROR, TË DEFINUARA BASHKËRISHT
NGA ANA E GAZETARËVE DHE PËRFAQËSUESVE TË
ORGANIZATAVE CIVILE NË MAQEDONI**

REZULTATET E MONITORIMIT

TË RAPORTIMIT TË MEDIAVE LIDHUR ME TEMAT
ME INTERES SHOQËROR, TË DEFINUARA BASHKËRISHT
NGA ANA E GAZETARËVE DHE PËRFAQËSUESVE
TË ORGANIZATAVE CIVILE NË MAQEDONI

Shkup, mars 2017

Boton:

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) – Maqedoni
Bul. JNA 24-1/2, 1000 Shkup, Maqedoni
Tel./Faksi: +389 2 3290 280
E-mail: office.macedonia@birn.eu.com
web: www.birn.eu.com

Përgatiti:

Qendra e komunikimeve civile
Bul. Koço Racin nr. 26-1/2, 1000 Shkup, Maqedoni
Tel./Faksi: +389 2 3213 513
web: www.ccc.org.mk

Lekturoi: Olivera Korvezirovska

Shtypi: Vinsent grafika

Tirazhi: 100

Tirazh falas/jokomercial

Ky raport mundësohet me mbështetjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë amerikane të zhvillimit ndërkombëtar (USAID) në kuadër të Projektit të gazetarisë hulumtuese dhe bashkëpunimit midis mediave dhe sektorit civil, Programi i USAID për forcimin e pavarësisë së mediave në Maqedoni. Përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi është Rrjeti ballkanik i investigimit dhe raportimit, ndërsa vetë publikimi nuk pasqyron qëndrimet e USAID ose ato të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Partnerët e projektit





PËRMBAJTJA

	HYRJE	6
	METODOLOGJIA	8
	REZULTATET E MONITORIMIT	10
		Konstatimet kryesore 10
		Rezultatet e detajuara të monitorimit 12
	REKOMANDIMET	30



HYRJJE

Mediat janë një nga faktorët më të rëndësishëm shoqëror me ndihmën e të cilit qytetarët informohen lidhur me çështjet me interes publik. Në rrethana të tilla mediat kanë për detyrë t'u mundësojnë qytetarëve të fitojnë informatat e nevojshme për të marrë një qëndrim lidhur me çështje të caktuara me interes publik. Në këtë kontekst, duke u siguruar qytetarëve informata relevante dhe objektive, mediat ndikojnë në ngritjen e nivelit të përgjithshëm të kuptimit të politikave publike, duke lënë hapësirë për debate publike lidhur me politikat konkrete në të cilat përfshihen të gjithë faktorët shoqërorë. Nga ana tjetër, me rolin e mbrojtësit të interesit publik, mediat duke vepruar në emër të popullatës, hapin debate lidhur me probleme të caktuara të shoqërisë dhe bëjnë presione mbi pushtetin dhe mbi qendrat e ndryshme të interesit për të gjetur zgjidhje të problemeve konkrete.

Që mediat të jenë në gjendje të realizojnë me sukses rolin e tyre shoqëror, ato kanë nevojë për kushte pune adekuate, definimin dhe respektimin e standardeve etike dhe profesionale, por edhe për bashkëpunim me faktorët e tjerë shoqëror me fushëveprim të ngjashëm dhe që mbrojnë interesa të ngjashme. Në këtë kontekst, para së gjithash bëhet fjalë për bashkëpunimin me organizatat civile që gjithashtu janë një faktor shumë i rëndësishëm i shoqërisë civile, i cili kryesisht angazhohet për avancimin e politikave publike dhe për të siguruar një qasje sa më të mirë të qytetarëve në fushat e ndryshme të vendimmarrjes në shoqëri.

Në mbështetje të të sipërpërmendurës, Projekti i gazetarisë investigative dhe bashkëpunimit të mediave dhe sektorit civil, si pjesë e Programit të USAID për forcimin e pavarësisë së mediave në Maqedoni, në vitin 2013 hulumtoi mënyrën e raportimit të mediave lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm shoqëror dhe bashkëpunimin e mediave me organizatat civile gjatë raportimit të këtij lloji.

Monitorimi kishte për qëllim të sigurojë informata të mjaftueshme cilësore dhe relevante për analizimin e mënyrës në të cilën mediat në Maqedoni raportojnë lidhur me çështjet me interes shoqëror, të definuara me një debat të përbashkët të përfaqësuesve të organizatave civile dhe gazetarëve.

Analiza e rezultateve të monitorimit gjithashtu shërbeu edhe si një bazë për organizimin e punëtorive me gazetarë dhe organizata civile lidhur me rritjen e numrit dhe ngritjen e cilësisë së teksteve të mediave që kanë të bëjnë me temat e zgjedhura me interes të përbashkët.

Duke pasur për qëllim konstatimin e trendit të mënyrës së raportimit të mediave lidhur me temat në fjalë dhe vlerësimin e drejtimit të lëvizjes, në vitin 2016 u realizua një tjetër monitorim identik.

Monitorimi mundëson krahasimin e gjendjes së para tre viteve dhe gjendjes momentale, sipas të gjitha çështjeve të përfshira me monitorimin, si më poshtë vijon:

- Me çfarë intensitet mediat maqedonase raportojnë mbi temat e analizuara?
- Sa respektohen standardet profesionale kryesore të gazetarisë gjatë raportimit lidhur me temat konkrete?
- Sa është i balancuar dhe objektiv raportimi i mediave dhe sa konsultohen të gjitha anët e një historie konkrete?
- A janë tekstet e gazetarëve rezultat të hulumtimeve të tyre ose bëhet fjalë për raportime lidhur me ngjarjet e organizuara për temat konkrete?
- Sa janë të besueshme dhe relevante dhe cili është kredibiliteti i teksteve?

Përveç qëllimit kryesor, rezultatet e monitorimit mund të shërbejnë edhe si një bazë për të filluar aksione të tjera që do të kenë për qëllim përmirësimin e raportimit të mediave në përgjithësi, por edhe në veçanti për secilën nga temat e analizuara. Këto rezultate mund të ndihmojnë gazetarët për të detektuar pikat e dobëta të informimit të tanishëm dhe t'u shërbejnë si një udhërrëfyes për përmirësimin e raportimit të tyre. Ndërkaq, kjo analizë mund të ndihmojë organizatat për të detektuar dobësitë që kërkojnë një angazhim më të madh për të informuar opinionin rregullisht, në mënyrë profesionale dhe me objektivitet më të madh.



METODOLOGJIA

Metodologjia e monitorimit u definua në vitin 2013, kur u zhvillua edhe monitorimi i parë lidhur me mënyrën në të cilën mediat e zgjedhura raportojnë për dhjetë tema me interes shoqëror, tema këto të zgjedhura nga ana e gazetarëve dhe përfaqësuesve të organizatave civile.

Mediat, tekstet¹ e të cilave analizohen, janë zgjedhur në mbështetje të gjendjes së tyre, qëllimet e monitorimit, nevojat e analizimit të rezultateve të monitorimit, parimeve të projektit dhe përvojës së mëparshme në këtë fushë. Ndërkaq, gjatë zgjedhjes së mediave u mor parasysh rëndësia e tyre, shikueshmëria/lexueshmëria e tyre, prania e mediave elektronike dhe të shtypura, prania e mediave lokale dhe nacionale, mediave në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe mediave me pronarë të ndryshëm dhe politikë të ndryshme redaktuese.

Për qëllimet e analizës janë zgjedhur mediat në vijim:

- ➔ TVM1 – televizioni shtetëror, servisi publik në gjuhën maqedonase;
- ➔ Alsat M – televizioni nacional në gjuhën shqipe;
- ➔ TV Tera – televizioni lokal (rajonal) në gjuhën maqedonase në Manastir;
- ➔ Dnevnik – e përditshmja nacionale në gjuhën maqedonase dhe
- ➔ Vest² – e përditshmja nacionale në gjuhën maqedonase.

1 Fjala “tekstet” nënkupton tekstet gazetareske të publikuara në gazetatat dhe kronikat dhe informatat e tjera që mund të ndiqen gjatë lajmeve.

2 Sipas planit, në vend të gazetës “Vest”, pjesë e mediave të zgjedhur ishte dashur të jetë e përditshmja në gjuhën maqedonase “Fokus”, por si rezultat të mospublikimit të kësaj gazete, e njëjta u zëvendësua me gazetën “Vest”, si gazeta më e ngjashme me të.

Objekt i monitorimit direkt ishin tekste e këtyre mediave lidhur me temat e zgjedhura dhe një pjesë e këtyre temave të publikuara gjatë muajve qershor, shator dhe tetor të vitit 2016. Monitorimi paraprak trajtoi edicionet e këtyre mediave, gjatë muajve prill, maj dhe qershor të vitit 2013.

Bëhet fjalë për kombinimin e një monitorimi kuantitativ dhe kualitativ, i cili përveç të dhënave numerike ka siguruar edhe informata lidhur me cilësinë e teksteve të analizuara, në aspektin e respektimit të standardeve profesionale të gazetarisë.

Tekste e publikuara dhe përmbajtja e tyre, ndër të tjera, u analizuan lidhur me aspektet në vijim:

- Fusha/tema e trajtuar me tekste;
- Faqja/pjesa e lajmeve në të cilën është publikuar/transmetuar teksti ose kronika;
- Rubrika në kuadër të të cilës është publikuar teksti;
- Gjatësia e tekstit/kohëzgjatja e kronikës;
- Prezantimi i tekstit/lajmit në ballinë;
- Ilustrimi i tekstit;
- Autori i tekstit/kronikës;
- Lloji i zhanrit të tekstit;
- Numri, statusi dhe lokacioni i burimeve;
- Qasja fer dhe e balancuar;
- Arsyeja për të cilën është shkruar teksti;
- Konsultimi i palëve të prekura dhe mënyra në të cilën është transmetuar mendimi i tyre etj.

Monitorimi u realizua me ndihmën e plotësimit (në mënyrë të koduar dhe me përshkrim) të pyetësorëve (formularëve) të përgatitur dhe të strukturuar paraprakisht për monitorim. Më konkretisht u monitorua çdo tekst i gjetur lidhur me një nga temat e zgjedhura.

Pyetësorët/formularët pas plotësimit të tyre u shqyrtuan, proceduan dhe sublimuan në një matricë të veçantë, me të cilën u siguruan rezultatet përmbledhëse të monitorimit, të cilat shërbyen si bazë për përgatitjen e analizës.

Objekt i analizës ishin rezultatet përmbledhëse të monitorimit dhe jo rezultatet e veçanta të mediave të monitoruara.


















REZULTATET E MONITORIMIT



Konstatimet kryesore

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një monitorim të zhvilluar në vitin 2016, me të njëjtën metodologji dhe me të njëjtat media si në vitin 2013, që të konstatohen trendet e mënyrës në të cilën mediat raportojnë lidhur me temat me interes shoqëror.

-  Me monitorimin e ri është ulur numri i përgjithshëm i teksteve që kanë të bëjnë me temat me interes shoqëror. Në vitin 2016 mesatarisht u monitoruan nga 3 tekste në ditë, për dallim nga viti 2013, kur u monitoruan mesatarisht nga 4 tekste të tilla.
-  Cilësia e teksteve është përmirësuar në masë të madhe sipas të gjitha parametrave të analizuara, megjithëse ka shumë vend për përmirësim të mëtejshëm në aspektin e standardeve profesionale kryesore, vërtetësinë, relevancën, besimin dhe kredibilitetin e teksteve dhe në aspektin e hulumtimit dhe analizimit më gjithëpërfshirës dhe më të detajuar të temave të trajtuara.
-  Tema për të cilën raportuan më së shumti mediat është “Sundimi i drejtë”, për dallim nga viti 2013, kur më e pranishme ka qenë tema “Anëtarësimin në Bashkimin Evropian”, temë kjo e cila me këtë monitorim u pozicionua në vendin e fundit, si temë që është trajtuar më pak.
-  Me monitorimin e fundit u konstatua se është dyfishuar numri i teksteve më të gjata dhe është ulur numri i teksteve më të shkurtra, që do të thotë se temave u është dhënë më shumë hapësirë në mediat.
-  Rritet përqindja e teksteve që prezantohen në ballinat e gazetave dhe në lajmet kryesore. Kjo do të thotë se vetë mediat gjithnjë e më shumë i reklamojnë teksteve në fjalë që lë përshtypjen se ato janë të vetëdijshme për cilësinë e teksteve përkatëse ose ndikimin e tyre mbi masën.

-  Gjithnjë e më shumë tekste ilustrohen me fotografi të përgjithshme ose me fotografi origjinale dhe autentike dhe filmime lidhur me temat që trajtohen.
-  Rritet numri i teksteve në të cilat qëndron emri i gazetarëve/autorëve që kanë përgatitur tekstet përkatëse. Rritet numri i teksteve në të cilat qëndron emri i autorit, në raport me tekstet që publikohen pa emrin e autorit.
-  Në aspektin e zhanrit, vazhdojnë të dominojnë lajmet, por rritet numri i analizave dhe reportazheve, ndërsa përqindja e storieve hulumtuese ka mbetur në 3%.
-  Mbi gjysma e teksteve janë me dy, tre ose më shumë burime, ndërsa ulet numri i teksteve me një ose pa asnjë burim. Në masë të madhe ulet numri i teksteve pa burime.
-  Numri i teksteve në të cilat prezantohen burimet është rritur, në raport me tekstet me burime anonime ose pa burime, numri i të cilave është në ulje.
-  Mbi gjysma e teksteve edhe më tej janë me një palë, por rritet numri i teksteve që trajtojnë dy, tre ose më shumë palë.
-  Në dy të tretat e teksteve është konsultuar vetëm njëra palë e stories, që do të thotë se nuk ka pasur ndryshime me monitorimin e vitit 2013.
-  Ministrinë dhe sidomos Qeveria shfaqen më pak si burime të teksteve dhe njëkohësisht rritet shfrytëzimi i burimeve të vetëqeverisjes lokale, gjykatave, prokurorisë dhe sindikatave. Organizatat civile si burime informatash edhe më tej trajtohen me një pjesë të vogël të teksteve.
-  Është ulur numri i teksteve që bazohen në pseudo-ngjarje (konferencë për shtyp, njoftim, deklaratë etj.), në raport me tekstet që bazohen në ngjarje origjinale ose autentike. Vetëm 8% e teksteve janë përgatitur si rezultat të investigimeve të gazetarëve.
-  Institucionet qeveritare, më pak partitë dhe më shumë institucionet lokale dhe gjykatat, paraqiten si organizatorë të pseudo-ngjarjeve që kanë qenë shkas për përgatitjen e teksteve me interes shoqëror. Nëntë për qind të teksteve bazohen në ngjarje të organizuara nga organizatat civile.



Rezultatet e detajuara të monitorimit

Objekt monitorimi dhe analize ishin gjithsej 300 tekste lidhur me dhjetë temat me interes shoqëror, të cilat u publikuan në mediat e zgjedhura gjatë periudhës së monitorimit. Duke ditur që gjatë periudhës së monitorimit pesë mediat e zgjedhura kanë pasur 93 botime/edicione, në nivel ditor janë publikuar nga tre tekste lidhur me temat e analizuar.


1. Temat



“Anëtarësimi në BE”, temë kjo më e pranishme në mediat gjatë periudhës së monitorimit të vitit 2013, u bë tema që është trajtuar më pak nga ana e mediave: Dallimi kryesor midis raportimit të mediave mbi temat e zgjedhura me interes shoqëror në vitin 2013 dhe në vitin 2016, në aspektin e pranisë së temave qëndron në faktin se në vitin 2016 tema më e trajtuar ka qenë “Sundimi i drejtë”, për të cilën janë shkruar ose përgatitur 25% të teksteve, ndërsa në vitin 2013 tema më e trajtuar ka qenë “Anëtarësimi në BE”, për të cilën janë shkruar ose përgatitur 17% të teksteve ose kronikave. Me monitorimin e vitit 2016 u konstatua se kjo temë u pozicionua në vendin e fundit, si tema që është trajtuar më pak ose vetëm me 1% të teksteve ose kronikave.


Tema më e pranishme ose tema për të cilën mediat kanë publikuar më shumë tekste gjatë periudhës së monitorimit është “Sundimi i drejtë”. Pas saj vijon tema “Cilësia e jetës”, pas të cilës me një numër të ngjashëm u gjetën temat në vazhdim: “Arsimi dhe të rinjtë”, “Ambienti jetësor”, “Të drejtat e njeriut” dhe “Shëndetësia dhe të drejtat e pacientit”. Tema me më pak tekste ose tema me prani më të vogël në dhjetë mediat e analizuar është “Anëtarësimi në BE”, ndërsa temat me më pak tekste të publikuara janë: “Politika kulturore”, “Përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri” dhe “Raportet ndëretnike”

Temat për të cilat janë shkruar tekstet



Krahasimi i këtij monitorimi me atë të vitit 2013 zbardh dallimet midis temave më të trajtuara. Tema më e trajtuar para tre vitesh “Anëtarësimi në BE” me monitorimin e fundit u pozicionua në vendin e fundit midis temave më të trajtuara. Gjithashtu, një rritje të madhe ka shënuar numri i teksteve të temës më të trajtuar në vitin 2016, ajo e “Sundimit të drejtë”, e cila në vitin 2013 u trajtua vetëm me 14% të teksteve, ndërsa në vitin 2016 e njëjta u trajtua me një të katërtën e teksteve ose me 25% të tyre.

Krahasimi midis pranisë së temave në vitet 2013 dhe 2016




2. Gjatësia e teksteve

Rritje e numrit të teksteve të gjata dhe ulje e numrit të teksteve të shkurtra: Në vitin 2016 teksteve të përgatitura lidhur me temat me interes shoqëror u është dhënë më shumë hapësirë, në raport me vitin 2013. Në vitin 2016 dy të tretat e teksteve janë tekste të gjata (66%), ndërsa në vitin 2013, tekste të gjata kanë qenë pak më shumë se një e treta e teksteve(38%). Në raport me vitin 2013, në vitin 2016 janë regjistruar dyfish më pak tekste të shkurtra.




Megjithëse bëhet fjalë për tema me interes shoqëror, për të cilat pritet që tekstet gazetareske të jenë më të gjata, tekstet e analizuara kanë qenë me gjatësi të ndryshme. Dominojnë tekstet e gjata (66%), shumë më pak tekste kanë qenë me gjatësi të mesme(19%), ndërsa tekste të shkurtra kanë qenë 15% të numrit të përgjithshëm të teksteve.

Gjatësia e teksteve



Në raport me monitorimin e parë, regjistrohet një përmirësim i madh në këtë aspekt ose është dyfishuar numri i teksteve të gjata, për dallim nga teksteve të shkurtra, numri i të cilëve është përgjysmuar. Kjo do të thotë se temave me interes dhe rëndësi shoqërore në vitin 2016 u është dhënë shumë më tepër hapësirë në mediat, krahasuar me vitin 2013.

Krahasimi i teksteve në vitet 2013 dhe 2016 në aspektin e gjatësisë së tyre




3. Prezantimi i tekstit në ballinë/lajmet kryesore

Më shumë tekste janë prezantuar në ballinë/lajmet kryesore: Përqindja e teksteve me interes shoqëror, që janë publikuar në ballinat e gazetave ose janë prezantuar me lajmet kryesore të televizioneve, në vitin 2016 është më e lartë (36%), në raport me vitin 2013 (25%).



Megjithëse 64% të teksteve kanë trajtuar tema me interes shoqëror, ato nuk janë prezantuar në ballinat e gazetave ose me lajmet kryesore të televizioneve. Ndërkaq, 36% të teksteve, më saktësisht titujt e tyre ose një pjesë e përmbajtjeve, janë prezantuar në ballinat e gazetave ose në fillim të lajmeve të televizioneve. Prezantimi i teksteve në ballinat e gazetave ose në fillim të lajmeve zakonisht ka të bëjë me cilësinë e tyre. Më saktësisht, në rast se mediat vlerësojnë se teksti konkret zbulon diçka me rëndësi dhe me interes për publikun, ato e publikojnë në ballinë ose në fillimin e lajmeve kryesore, për të tërhequr vëmendjen e lexuesit ose shikuesit.


A është publikuar teksti në ballinë/në fillimin e lajmeve kryesore?



Edhe me monitorimin e fundit u vërtetua se ky numër korrespondon me numrin e teksteve që mund të cilësohen si tekste më cilësore në aspektin e burimeve të tyre, praninë së palëve të trajtuara, konsultimit dhe citimit të palëve që trajtohen etj. Kjo nënkupton se në ballinat e gazetave ose lajmet kryesore të televizioneve prezantohen përmbajtjet më cilësore që rezultojnë me konkluzionin se mediat janë të vetëdijshme për cilësinë e punës së tyre dhe nëse do të kishin më shumë tekste cilësore ato do t'i publikonin ose prezantonin në ballinë ose me lajmet kryesore.

Krahasimi me monitorimin e para tre viteve në aspektin e çështjes konkrete zbardh një lloj përmirësimi. Më konkretisht, në vitin 2013 në ballinat e gazetave ose me lajmet kryesore janë prezantuar vetëm një e katërta (25%) e temave me interes shoqëror, ndërsa në vitin 2016 kjo përqindje është rritur në mbi një të tretën e teksteve ose në 36%.

Krahasimi i prezantimit të teksteve në vitet 2013 dhe 2016




4. Ilustrimi i teksteve



Më pak tekste pa ilustrime: Për dallim nga viti 2013, vit ky kur 21% e teksteve me interes shoqëror janë publikuar pa asnjë fotografi ose ilustrim me video, në vitin 2016 kjo përqindje u ul në 7%.


Plotë 42% e teksteve janë ilustruar me fotografi origjinale ose autentike ose filmime që trajtojnë drejtpërdrejtë temën e trajtuar. Gjysma e teksteve ose 51% e tyre janë ilustruar me fotografi të përgjithshme që kanë të bëjnë ose që lidhen me temën konkrete, ndërsa 7% e teksteve janë publikuar pa asnjë fotografi ose pa ilustrime.

Tekste të publikuara me fotografi/filmime



Gjendja e konstatuar, megjithëse është përmirësuar në raport me atë të vitit 2013, kur 21% e teksteve janë publikuar pa asnjë fotografi ose pa ilustrime, nuk i plotëson standardet e profesionit sepse për temat me interes shoqëror është me rëndësi kryesore që gjithmonë kur është e mundur të shoqërohen me fotografi ose filmime burimore, që do t'u mundësojnë qytetarëve të kuptojnë më mirë ose plotësisht problematikën e trajtuar dhe të informohen më mirë.

Krahasimi i ilustrimit të teksteve në vitet 2013 dhe 2016



5. Autorë të teksteve


Më pak tekste pa emrin e autorit: Autorët e teksteve në vitin 2016 kanë nënshkruar me emër dhe mbiemër 56% të teksteve, në raport me vitin 2013 kur kjo përqindje ka qenë 49%. Në vitin 2013 pa emrin dhe mbiemrin e autorit janë publikuar 25% të teksteve, ndërsa në vitin 2016 kjo përqindje është ulur në 15%.



Mbi gjysma e teksteve (56%) që kanë trajtuar tema me interes shoqëror, janë nënshkruar me emrin dhe mbiemrin e autorit. Mbi një të katërtën e teksteve, autorët kanë nënshkruar tekstet e tyre vetëm me inicialet (13%), ndërsa 15% e teksteve janë publikuar pa autorë. Ndërkaq 13% e teksteve janë nënshkruar vetëm me inicialet e autorit, 1% e teksteve janë marrë nga mediat e tjera, ndërsa 14% prej tyre janë lexuar nga prezantuesi i lajmeve.


Monitorimi i fundit ka vërtetuar se mbetet e lartë përqindja e teksteve anonime ose që publikohen vetëm me inicialet e autorit (42%), ndërsa kjo përqindje ka të bëjë me zhanrin ose me faktin se kemi të bëjmë me lajme të shkurtra që publikohen pa emrin e autorit, nënshkruhen vetëm me inicialet e tij ose lajme që lexohen nga prezantuesi i lajmeve.

Publikimi i emrit të autorit të tekstit



Krahasuar me vitin 2013, në vitin 2016 regjistrohen përmirësime edhe në aspektin e identifikimit të autorëve të teksteve. Në vitin 2016 tekstet n 56% të rasteve janë publikuar me emrin dhe mbiemrin e autorit(në vitin 2013 kjo përqindje ka qenë 49%). Ndërkaq, në masë të madhe është ulur numri i teksteve të cilat në vitin 2016 janë publikuar pa emrin e autorit (15%), në raport me vitin 2013 (25%). Publikimi i emrit të autorit vlerësohet se ndikon në masë të madhe në forcimin e kredibilitetit të medias, duke forcuar besimin e qytetarit. Nga ana tjetër, tekstet pa emrin e autorit humbin relevancën dhe lënë hapësirë për dyshime sipas të cilave arsyeja kryesore e publikimit të një teksti konkret nuk është informimi objektiv i opinionit.

Publikimi i emrit të autorit në vitet 2013 dhe 2016




6. Zhanret

Më pak lajme, më shumë analiza: Nuk ka ndryshim të madh në aspektin e zhanreve: Në vitin 2016, në raport me vitin 2013, një ulje të vogël ka shënuar numri i teksteve që i përkasin zhanrit lajm dhe lajm i zgjeruar dhe njëkohësisht rritje kanë shënuar teksteve e zhanreve të tjera, siç janë analiza dhe reportazhi.




Megjithëse kemi të bëjmë me tema me interes shoqëror që nënkuptojnë praninë e zhanreve të tjera përveç lajmeve, 69% të teksteve kanë qenë lajme, 20% nga të cilat lajme të zakonshme dhe 49% lajme të zgjeruara. Pas tyre vijon analiza, si një zhanr i pranishëm me 11% dhe reportazhi me 4%. Ndërkaq, storiet hulumtuese kanë qenë të pranishme vetëm në 3% të përmbajtjeve të analizuar, njësoj si intervista.

Zhanri i tekstit/kronikës



Në raport me vitin 2013 përmirësime janë konstatuar vetëm në aspektin e numrit më të madh të teksteve të zhanreve të tjera, siç janë analiza dhe reportazhi, për dallim nga numri më i vogël i teksteve që u përkasin dy zhanreve kryesore, lajmit dhe lajmit të zgjeruar. Kjo gjendje korrespondon edhe me teksteve më të gjata në vitin 2016, krahasuar me vitin 2013. Nëse në vitin 2013 rreth 74% të teksteve kanë qenë të zhanrit lajm, në vitin 2016 kjo përqindje është ulur në 69%. Për një pikë procentuale është rritur prania e analizës (nga 10% në 11%) dhe reportazhit (nga 3% në 4%). Ndryshime nuk ka pasur tek storiet hulumtuese, zhanr ky të cilit i përkasin 3% të teksteve në vitin 2013 dhe vitin 2016. Megjithëse regjistrohet një përmirësim i vogël në raport me vitin 2013, gjendja mbetet shqetësuese, duke pasur parasysh faktin se për një pjesë të madhe të temave të trajtuara, informimi më objektiv i qytetarëve mund të mundësohet vetëm me hulumtime më gjithëpërfshirëse të gazetarëve.

Krahasimi i zhanreve të teksteve në vitet 2013 dhe 2016




7. Numri i burimeve



Përmirësimet më të rëndësishme: Në një masë të madhe është përmirësuar gjendja me numrin e burimeve në tekstet e analizuar në vitin 2016, në raport me tekstet e vitit 2013. Rritje ka shënuar numri i teksteve me dy burime, ndërsa është ulur numri i teksteve me një burim ose pa burime.


Analiza e vitit 2016 ka vërtetuar se 39% të teksteve kanë qenë me një burim informatash, ndërsa vetëm 2% të teksteve kanë qenë pa burim informatash. Me dy burime kanë qenë 36% të teksteve, ndërsa 3 dhe më shumë burime kanë pasur 23% të teksteve. Përmendja e burimeve të informatave dhe zbardhja e origjinës së tyre, konsiderohen dy nga parimet kryesore të gazetarisë profesionale, që u japin shkrimeve gazetareske vërtetësi dhe kredibilitet.

Burimet - numri



Në raport me rezultatet e monitorimit të mënyrës në të cilën kanë raportuar mediat lidhur me temat me interes shoqëror të vitit 2013, një përmirësim i madh regjistrohet në aspektin e numrit të burimeve të informatave me të cilat janë përgatitur tekstet. Rritje nga 17% në 36% ka shënuar numri i teksteve me dy burime, ndërsa nga 53% në 39% është ulur numri i teksteve me një burim dhe nga 7% në 2% është ulur numri i teksteve pa burime informatash.

Krahasimi i numrit të burimeve të informatave në vitet 2013 dhe 2016




8. Statusi i burimeve

Më shumë burime të identifikuar, më pak burime anonime: Numri i teksteve me burime të identifikuar është rritur në raport me numrin e teksteve me burime anonime.




Në aspektin e statusit të burimeve vazhdojnë të dominojnë tekstet me burime të identifikuar (88%), ndërsa vetëm 2% të teksteve kanë qenë me burime anonime. Burime të identifikuar dhe burime anonime kanë pasur 8% të teksteve, ndërsa 2% të teksteve kanë qenë pa burime.

Burimet - statusi



Në aspektin e statusit të burimeve regjistrohet një përmirësim i vogël që nuk mund të konsiderohet si përmirësim jo i rëndësishëm sepse kemi të bëjmë me rritje procentuale të pranishëm të teksteve me burime të identifikuar nga 86% në 88% dhe ulje të numrit të teksteve me burime anonime nga 3% në 2%. Gjithashtu është rritur edhe numri i teksteve me burime të identifikuar dhe burime anonime, nga 4% në 8% dhe është ulur numri i teksteve pa burime nga 7% në 2%.

Krahasimi i statusit të burimeve të teksteve në vitet 2013 dhe 2016




9. Subjektet e storieve



Në storiët janë përfshirë më shumë subjekte: Në raport me vitin 2013, në vitin 2016 është rritur prania e teksteve me dy dhe më shumë subjekte që trajtohen me një storie konkrete dhe njëkohësisht është ulur numri i teksteve që trajtojnë vetëm një subjekt.


Vetëm një subjekt kanë trajtuar 53% të teksteve, 30% të teksteve i kanë trajtuar të dy subjektet/anët e stories, ndërsa me 15% të storieve janë trajtuar më shumë anë/individë/subjekte. Balancimi i burimeve të informatave ose prezantimi i të dy anëve (ose të të gjitha anëve/subjekteve të stories) është një nga rregullat thelbësore të gazetarisë për arsye se me prezantimin e njëjës anë të stories konkrete vihet në pikëpyetje objektiviteti i gazetarit ose medias.

Burimet - subjektet e stories



Në aspektin e pranisë së subjekteve të trajtuara me tekstet është konstatuar një nga përmirësimet më të rëndësishme lidhur me mënyrën e raportimit të mediave për temat me interes shoqëror në vitin 2016, në raport me vitin 2013. Nëse në vitin 2013 vetëm një subjekt është trajtuar me 66% të teksteve, kjo përqindje në vitin 2016 është ulur në 53%. Gjithashtu është përmirësuar edhe numri i teksteve me dy dhe më shumë subjekte të trajtuara, më konkretisht prania e teksteve me dy subjekte është rritur nga 21% në 30%, ndërsa numri i teksteve që kanë trajtuar më shumë subjekte është rritur nga 6% në 15%.

Krahasimi i subjekteve/anëve të teksteve në vitet 2013 dhe 2016




10. Lloji i burimit të informatave



Si burime informatash më shumë kanë shërbyer institucionet shtetërore dhe më pak institucionet dhe sektorët e tjerë: Ndryshimi kryesor në aspektin e burimit të informatave në vitin 2013 dhe 2016 ka të bëjë me faktin që ministrinë dhe veçanërisht qeveria paraqiten më pak si burime informatash të teksteve të trajtuara, për dallim nga rritja e numrit të burimeve të informatave që vijnë nga pushteti lokal, gjykatat, prokuroria dhe sindikata.

Pjesa më e madhe e burimeve të trajtuara dhe të përmendura me tekstet e analizuara vijnë nga institucionet shtetërore (qeveria, ministrinë, agjencitë shtetërore etj.), të cilave u përkasin 31% të numrit të përgjithshëm të burimeve të informatave. Pas tyre, në aspektin e pranisë së burimeve të informatave, vijnë burimet që vijnë nga organet e vetëqeverisjes lokale (9%) dhe ato që vijnë nga sektori civil (8%). Menjëherë pas tyre vijnë burimet që vijnë nga partitë politike (7%), ato që vijnë nga pushteti gjyqësor (5%) dhe ato që vijnë nga sektori i biznesit (4%). Me një prani prej 3% marrin pjesë burimet që vijnë nga universitetet, prokuroria, institucionet shëndetësore dhe sindikatat. Ndërkaq, numri më i vogël i burimeve të informatave vijnë nga institucionet e arsimit (2%) dhe ato të kulturës.




Në raport me vitin 2013, përmirësim regjistrohet në aspektin e rritjes së numrit të burimeve që vijnë nga institucionet e tjera, përveç institucioneve shtetërore, Qeverisë, ministrive dhe organeve të tjera shtetërore. Në vitin 2016 është ulur

numri i teksteve që janë përgatitur me burime informatash që vijnë nga institucionet shtetërore, më saktësisht me burime informatash që vijnë nga qeveria janë përgatitur vetëm 1% të teksteve (në vitin 2013 me burime të këtij lloji janë përgatitur 8% të teksteve të trajtuara), ndërsa me burime informatash që vijnë nga ministritë janë përgatitur 13% të teksteve (në vitin 2013 me burime të këtij lloji janë përgatitur 18% të teksteve të trajtuara). Nga ana tjetër, është rritur numri i burimeve që vijnë nga organet e vetëqeverisjes lokale nga 6% në 9%, numri i burimeve të informatave që vijnë nga gjykatat nga 1% në 5%, ai i burimeve që vijnë nga Prokuroria nga 0,5% në 3% dhe numri i burimeve të informatave që vijnë nga sindikatat nga 0,5% në 3%.

Organizatave civile si burime informatash kanë shërbyer në 8% të storiave të trajtuara. Ndërkaq, ndryshime nuk janë regjistruar në aspektin e shfrytëzimit të sektorit të biznesit si burim informatash (4%), partive politike (7%), ekspertëve universitarë (3%), institucioneve arsimore (2%) dhe institucioneve kulturore (2%).

Krahasimi i llojit të burimeve të informatave në vitet 2013 dhe 2016




11. Konsultimi i palës që trajtohet me storien



Nuk ka ndryshime: Nuk janë konstatuar ndryshime në aspektin e konsultimit të palëve të trajtuara me tekstet e analizuar. Si në vitin 2013 ashtu edhe në vitin 2016 me 63% të teksteve të analizuar nuk është konsultuar pala e trajtuar me storien konkrete.

Palët e trajtuara me tekstin/storien konkrete nuk është konsultuar me rreth dy të tretat e teksteve (63%). Në një të tretën e rasteve kur është konsultuar pala e trajtuar me tekstin konkret ajo ka dhënë deklaratë (33%), ndërsa vetëm në 4% të teksteve pala e trajtuar është konsultuar, por nuk ka dashur të jap deklaratë. Në këtë mënyrë tekstet bëhen më pak objektive sepse me vetë faktin që nuk konsultohet pala e trajtuar vihet në pikëpyetje trajtimi fer, që në fakt duhet të jetë elementi i detyrueshëm i çdo teksti gazetaresk. Trajtimi fer nënkupton trajtimin pa favorizime të të gjitha palëve/subjekteve të trajtuara me storien konkrete, ndërsa në rastin konkret, me moskonsultimin e palëve të trajtuara me dy të tretat e teksteve është favorizuar pala tjetër e stories konkrete.

Konsultimi i palës së trajtuar




12. Arsyeja e punimit të tekstit



Më shumë tekste të përgatitura si rezultat të ngjarjeve autentike: Ngjarjet e „orkestruara“ në vitin 2016 kanë shërbyer më pak si arsye për përgatitjen e teksteve gazetareske, në raport me vitin 2013. Të njëjtin vit përparësi kanë pasur ngjarjet aktuale dhe autentike që kanë qenë arsye për përgatitjen e teksteve gazetareske.


Me një numër përfaqësues të njëjtë kanë qenë të pranishme tekstet me interes shoqëror që janë përgatitur si rezultat të ngjarjeve “të orkestruara” ose pseudo-ngjarjeve (41%) dhe ngjarjeve aktuale ose autentike (38%). Në 13% të teksteve të analizuar nuk mund të vlerësohet arsyeja e përgatitjes së tyre dhe publikimit në mediat përkatëse, ndërsa në 8% të rasteve tekstet janë përgatitur si rezultat të investigimeve autentike të gazetarëve.

Arsyeja e punimit të tekstit



Në këtë aspekt regjistrohen përmirësime të mëdha në raport me vitin 2013, vit ky gjatë të cilit pseudo-ngjarjet janë shfrytëzuar për përgatitjen e 60% të teksteve, në raport me vitin 2016 kur ngjarjet e këtij lloji janë shfrytëzuar për përgatitjen e 41% të teksteve të analizuar. Ndërkaq, ngjarjet aktuale ose autentike janë përdorur për përgatitjen e vetëm 18% të teksteve, ndërsa në vitin 2016 kjo përqindje është rritur më shumë se dy herë ose në 38%. Investigimet autentike të gazetarëve si arsye për përgatitjen e teksteve kanë mbetur në një nivel identik. Megjithëse flitet se kemi të bëjmë me tema me interes shoqëror, informimin e mediave lidhur me temat konkrete kryesisht “e orkestrojnë” faktorë që gjenden jashtë mediave. Në këtë mënyrë, mediat nuk e realizojnë plotësisht rolin e tyre shumë të rëndësishëm në shoqëri, ndërsa opinioni nuk fiton informata të pavarura dhe objektive që i nevojiten për të marrë vendime me rëndësi lidhur me jetën dhe punën e tyre.

Krahasimi i arsyeve të teksteve në vitet 2013 dhe 2016




13. Organizatorë të ngjarjeve

Në rolin e organizatorit më pak shfaqen Qeveria dhe partitë, ndërsa më shumë shfaqen institucionet lokale dhe gjykatat: Institucionet e tjera publike në vend të Qeverisë kryesojnë si organizatorë të pseudo-ngjarjeve që kanë shërbyer si arsye për përgatitjen e teksteve me interes shoqëror. Në vitin 2016 janë regjistruar më shumë ngjarje të organizuara nga institucionet në nivel lokal dhe gjykatat dhe më pak ngjarje të organizuara nga partitë politike, në raport me vitin 2013.


Institucionet e tjera publike, me përjashtim të institucioneve qeveritare, kryesojnë listën e organizatorëve të pseudo-ngjarjeve që kanë shërbyer si arsye për të raportuar për temat me interes shoqëror. Këto institucione kanë qenë organizatorë të pseudo-ngjarjeve në 18% të rasteve. Lista përkatëse vazhdon me institucionet qeveritare me 16% dhe vijojnë organizatat civile dhe gjykatat me nga 9% të ngjarjeve. Pushteti në nivel lokal ka qenë organizator i 8% të ngjarjeve, partitë politike kanë organizuar 4% të ngjarjeve, ndërsa sektori i biznesit 2% të ngjarjeve.

Organizatorë të ngjarjeve



Në raport me monitorimin e vitit 2013, kur institucionet qeveritare kanë organizuar shumicën e pseudo-ngjarjeve (27%) që kanë shërbyer si arsye e përgatitjes së teksteve gazetareske, në vitin 2016 më shumë ngjarje të këtij lloji kanë organizuar institucionet e tjera publike (18%), ndërsa institucionet qeveritare, si organizatorë të ngjarjeve të këtij lloji, paraqiten në 16% të rasteve. Shumica e teksteve të përgatitura në vitin 2016 kanë pasur për bazë ngjarjet e organizuara nga ana e institucioneve lokale (8% në vitin 2016, në raport me 4% në vitin 2013), ngjarjet e organizuara nga ana e institucioneve gjyqësore (9% në vitin 2016, në raport me 2% në vitin 2013) dhe ato të organizatave joqeveritare, të cilat kanë organizuar 9% të ngjarjeve ose një pikë procentuale më pak krahasuar me vitin 2013, kur këto organizata kanë organizuar 10% të ngjarjeve. Gjithashtu, ndryshime nuk regjistrohen në përqindjen e pranisë së burimeve që vijnë nga sektori civil, si burime të teksteve në vitin 2016 dhe në vitin 2013, që është përmendur në tekstin më sipër të këtij raporti.

Krahasimi i organizatorëve të ngjarjeve në vitet 2013 dhe 2016





REKOMANDIMET

Megjithëse konstatohet një lloj përmirësimi i mënyrës në të cilën mediat kanë trajtuar temat me interes shoqëror, përmirësimet duhet të vazhdojnë në të gjitha aspektet e trajtuara me monitorimin dhe analizën e rezultateve dhe për këtë arsye gazetarëve, mediave dhe organizatave civile u jepen rekomandimet në vazhdim:

1

Mediat të intensifikojnë informimin e opinionit për temat me rëndësi shoqërore, duke u mundësuar qytetarëve më shumë informata që u nevojiten atyre për të marrë pjesë reale dhe në mënyrë efikase në proceset që kanë ndikim në jetën dhe punën e tyre.

2

Gazetarët të zbatojnë standardet profesionale elementare në rastet e raportimit për temat me rëndësi shoqërore, duke raportuar saktë, në mënyrë të balancuar dhe fer dhe duke u kujdesur për saktësinë, besimin dhe kredibilitetin e teksteve të tyre, më saktësisht:

- Të publikojnë fakte;
- Të kontrollojnë dhe vërtetojnë informatat e fituara;
- Të pasurojnë listat e burimeve dhe të citojnë më shumë se një burim të dhënash;
- T'i përfshijnë dhe t'i konsultojnë të gjitha anët e stories;
- T'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha palët e stories;
- Të sigurojnë dhe të ofrojnë prova për historitë e tyre;
- Në të gjitha rastet kur është e mundur të ilustrojnë tekstet me fotografi dhe filmime origjinale dhe autentike;
- Të nënshkruajnë tekstet e tyre me emër dhe mbiemër.

- 3 Gazetarët të praktikojnë që pronarët të mbështesin, ndërsa redaktorët të inkurajojnë gazetarinë hulumtuese lidhur me temat me interes shoqëror, si një mënyrë në të cilën mediat do të realizojnë rolin e tyre shoqëror dhe të risin besimin dhe kredibilitetin në opinion, duke rritur njëkohësisht edhe të ardhurat e tyre.
- 4 Mediat të investojnë (mjete, kohë, teknikë dhe përpjekje) për edukimin plotësues të gazetarëve dhe redaktorëve, jo vetëm për të respektuar standardet profesionale elementare të profesionit, por për të pasuruar teknikat dhe metodat e gazetarisë investigative.
- 5 Mediat t'u mundësojnë gazetarëve të drejtat dhe mbrojtje plotësuese për të informuar opinionin me profesionalizmin dhe objektivitetin e duhur, ndërsa gazetarët në këtë drejtim të mbështeten në dispozitat ligjore në fuqi.
- 6 Shoqatat dhe organizatat esnafe duhet të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të siguruar kushtet e nevojshme që gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave të realizojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe të liruar nga frika dhe presionet.
- 7 Organizatat civile të krijojnë raporte që sigurojnë komunikim të vazhdueshëm dhe jo komunikim ad-hok me mediat, duke ua ofruar mbështetjen e nevojshme (nga aspekti i ekspertëve dhe resurseve) gjatë hulumtimit dhe raportimit për temat me rëndësi shoqërore.
- 8 Organizatat civile në të gjitha projektet që i realizojnë, që kanë të bëjnë me interesin shoqëror, duhet të zhvillojnë aktivitete për edukimin e gazetarëve për të siguruar një informim më cilësor të qytetarëve.
- 9 Organizatat civile dhe mediat duhet të forcojnë bashkëpunimin në drejtim të realizimit të rolit të tyre shoqëror si faktorë kryesorë të proceseve demokratike në vend.
- 10 Donatorët vendas dhe të huaj të vazhdojnë përpjekjet për mbështetjen e gazetarëve, mediave dhe organizatave civile në drejtim të informimit profesional dhe objektiv të opinionit lidhur me proceset dhe temat me rëndësi shoqërore.



CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св.
Климент Охридски", Скопје

342.7:316.774(497.7)"2016"(047)
36:316.774(497.7)"2016"(047)

REZULTATET e monitorimit të raportimit të
mediave lidhur me temat me interes shoqëror, të
definuara bashkërisht nga ana e gazetarëve dhe
përfaqësuesve të organizatave civile ne Maqedoni. - Shkup : Rrjeti ballkanik i investigimit dhe
raportimit (BIRN), 2017. - 31
стр. : граф. прикази ; 25 см

Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во
рамките на проектот: "Тë gazetarisë hulumtuese
dhe bashkëpunimit midis mediave dhe sektorit
civil"

ISBN 978-608-65520-4-6

а) Јавен интерес - Новинарско известување
- Македонија - 2016 - Извештаи б) Медиуми -
Унапредување на јавни добра - Македонија -
2016 - Извештаи

COBISS.MK-ID 102991370